



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 04.09.2023, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të "Delta Invest", SHPK.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika:
 1. Pjesa e parcelës kadastrale, nr. 07164-3, me sipërfaqe prej 719m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-07164-3, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës, me destinim ndërtim sipas Plotësim-ndryshim të Planit rregullues "Arbëria 3", miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-35-94056, dt. 04.05.2015.
 2. Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, janë parcelat kadastrale nr. 01706-7, me sipërfaqe 33m², Zona kadastrale Matiçan - Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-01706-7, 01706-9, me sipërfaqe 79m², Zona kadastrale Matiçan - Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-01706-9, 01706-11, me sipërfaqe 347m², Zona kadastrale Matiçan Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-01706-11, 01299-0 me sipërfaqe 679m², Zona kadastrale Matiçan - Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P- 71914050-01299-0 dhe 01300-0, me sipërfaqe 386m², Zona kadastrale Matiçan - Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-01300-0, në pronësi të "Delta Invest", SHPK, me destinim infrastrukturë rrugore dhe gjelbërim, të planifikuar sipas Planit rregullues "Prishtina e re - Zona Lindje" i miratuar me Vendimin nr. 01, nr.35-186833, të dt. 02.10.2013.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për shkak të realizimit të projektit të rrugës "A", sipas Planit rregullues "Prishtina e re - Zona Lindje".
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.

- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
 - kopjet e planit dhe
 - certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/06-183709/23, më 05.09.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Pëllumb Bajcinova



Arsyetim

Ne baze te kërkesës se Kryetarit te Kryeqytetit dhe Drejtorise se Investimeve Kapitale, qe te fillojmë me procedurën e kompenzimit per parcelat te cilat përfshihen brenda planit rregullues per zhvillimin e projektit te rrugës "A", si dhe bazuar në Planin Rregullues "Prishtina e re – Zona Lindje" i miratuar me vendimin nr. nr.01nr.35-186833, dt. 02.10.2013, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e parcelave kadastrale nr. 01706-7, sip.33m², 01706-9, sip.79m², 01706-11, sip.347m², 01299-0, sip.679m² dhe 01300-0, sip.386m², Zona kadastrale Matican Prishtinë në pronësi të Delta Invest Sh.P.K, me destinim infrastrukture rrugore të cilat përfshihen në kuadër të projektit te rrugës "A" Jim Xhema Prishtine. Pjesa e parcelës kadastrale me nr. 07164-3, me sip. 719m², Z.K Prishtinë, në pronësi të Komuna e Prishtines, me destinim ndertim te planifikuar sipas Planit Rregullues "Arberia 3", miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-35-94056, dt.04.05.2015.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të projektit te rruges "A" sipas planit rregullues "Prishtina e re – Zona Lindje".Parcelat me nr. 01706-7, sip.33m², 01706-9, sip.79m², 01706-11, sip.347m², 01299-0, sip.679m² dhe 01300-0, sip.386m², me sipërfaqe totale 1524m², Zona Kadastrale Matican Prishtinë shtrihen në zonë të planifikuar për infrastrukture rrugore dhe gjelberim, ndërsa parcela me nr. 07164-3, me sip.719m², Z.K Prishtinë, sipas planit rregullues "Arberia 3" Prishtine, shtrihet në zone te planifikuar për ndërtim.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.